



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V-të (IV-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtrri mbajtur më 29.4. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:15**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: Bajram Mulaku, kryetar i Komunës, Xhevahire Izmaku, nënkryetare e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka kuorum për punë.

Ferit Idrizi- propozoi që para se të del për diskutim rendi i ditës, të hiqet pika 5 e rendit të ditës, kurse në mbledhjen e kaluar e kemi pasë një draftregullore për shpërndarjen e materialit ndërtimor, e cila iu ka nënshtruar diskutimit publik sipas afatit të paraparë dhe nuk e kemi fut në rend dite, prandaj kërkoi që ajo të futet në rend dite, pasi që tash është shqyrtimi final i draftregullores në fjalë dhe duhet të qitet për aprovim.

Refik Ramaj- propozoi që të heqen të gjitha pikat e rendit të ditës, pasi që nuk janë përgatit materialet mirë për këtë seancë, pastaj e arsyetoi duke thënë se në materialet tona nuk janë futur pasqyrat financiare të Komunës, të cilat në mbledhjen e parafundit kanë qenë dhe është votuar që ato të sillen edhe një herë në shqyrtim, gjithashtu plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditorëve për pasqyrat financiare dhe për prokurimet. Drejtori i prokurimit e ka sjellë një plan, por na kemi kërkuar që të vjen i përmirësuar. Në vazhdim kërkoi që të heqet pika 3 e rendit të ditës, pasi që kemi dy drafte: drafti i parë është dashtë me qenë në diskutim publik, kurse drafti i USAID-it është tash në material, kurse drafti që është dashtë me qenë në diskutim publik nuk është në material. Pastaj tha që draftrregullorja për shqyrtimin e kriterëve na ka ardhur sot, por kjo ka munguar, nuk e kemi pasë në material në mënyrë që ta shqyrtojmë dhe të përgatitemi. Gjithashtu nuk janë në rend dite kërkesat e grupit asambleistë të LDK-së: mbrojtja e ambientit, dhe informata për masat për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm. Për pikën 8 të rendit të ditës, tha se në material përdoret termi urdhëresë, kurse titulli është propozimvendim, dhe

nuk e kemi të qartë pasi që urdhëresë mund të japë Kryetari, kurse propozimvendimet i shqyrton Kuvendi, prandaj kërkoi që kjo të përmirësohet. Kurse për pikën 6, tha se nuk e kemi të qartë situatën, dhe kërkoi sqarim bindës profesional, pasi që na si njerëz joprofesional me këtë Informatë që kemi, nuk e kemi të qartë dhe nuk dijmë qysh me vendos. Mandej kërkoi nga kryesia e Kuvendit që ta blen një projektor dhe në raste të tilla t'i shohim çështjet në projektor.

Sabit Kadriu- tha që në “eventuale” është dashtë të debatohet, ose të marrim informacione lidhur me rrugën Vushtrri-Duboc, pasi që në kilometrin e pestë është e shkatërruar rruga si pasojë e shiut dhe shembjeve, dhe për çdo ditë po rrezikohen kalimtarët. Pastaj tha që kemi bërë një shkresë zyrtare për Komunën e Vushtrrisë, kanë dal disa përfaqësues të Komunës dhe e kanë incizuar vendin e ngjarjes, por nuk ka pas ndërhyrje deri sot, duke kërkuar që të debatohet për këtë çështje përderisa akoma nuk ka ndodhur ndonjë tragjedi, edhe pse kjo është në kompetencë të Ministrisë së Transportit, por megjithatë deri sa të merret Ministria e Transportit, na duhet të interesohemi për qytetarët e Komunës sonë. Gjithashtu tha se rruga Vushtrri-Stroc-Zhilivodë është shndërruar në gropa dhe për çdo ditë ata që kalojnë në atë pjesë ballafaqohen me probleme, me gropa, prandaj kërkoi që edhe kjo çështje të bëhet pjesë e këtij debati.

Muharrem Shabani- tha se pajtohet me pjesën dërmuese të asaj që e tha përfaqësuesi i grupit asambleist të LDK-së, pasi që shumë gjëra që kemi kërkuar edhe më herët në disa materiale, duke akcentuar pikën 2 të rendit të ditës, kryesisht kemi të bëjmë me raport dhe me shënime statistikore të muajit mars, e jo të 3-mujorit. Prandaj duhet me qenë 3-mujor, në mënyrë që të analizohen detajisht disa elemente, mirëpo aty nuk ka asnjë kriter, asnjë analizë se çka e karakterizon këtë 3-mujor me të hyrat, mungon një komparacion me muajt apo një sezonë paraprake të caktuar 3-mujor, dhe të shikohet se a e kemi realizuar detyrat e tatimit në pronë. Pastaj tha që pajtohet që të hiqen disa pika rreth pronave, pa analiza, pasi që nuk mund të luajmë me prona. Në vazhdim kërkoi: që për të pasur një transparencë të plotë të punës së Kuvendit, në mënyrë që qytetarët e Vushtrrisë të shohin aktivitetin e organit më të lartë në Komunën e tyre, të gjendet formë që të angazhohet ndonjë televizion lokal. Kërkoi që qeveria komunale urgjentisht të dalë në terren dhe t'i shikoi pasojat e vërshimeve, pasi që më shumë se 1.000 hektarë janë të vërshuar, dhe propozoi formimin e një komisioni për të bërë incizimin e gjendjes. Në fund kërkoi Informatë të hollësishme rreth komosacionit.

Qazim Azemi- tha që pajtohet me atë që e tha R.Ramaj lidhur me pikat dhe materialet që i kemi marrë për këtë seancë. Në vazhdim paraqiti tri pyetje (kërkesa) për Kryetarin e Komunës: kërkohet të anulohet vendimi për riemërimin dhe ndërrimin e emrit të shkollës së mesme profesionale, pasi që dy shkollat në fjalë kanë emra dhe i kanë pasë emrat, kurse janë 6 shkolla tjera pa emër. Pastaj lidhur me kontratën që ka bërë Komuna jonë me firmën “6 vëllezërit Istrefi” kërkoi rishqyrtim të kësaj kontrate, për hir të interesave të Komunës, pasi që në këtë rast është dëmtuar interesi i Komunës, dhe se këtu ka edhe konflikt interesi, pasi që tenderin e ka fituar familja e këshilltarit të Kuvendit të Komunës. Në fund kërkoi Informatë lidhur me pranimin e drejtorëve të rinj në të dy afatet, emri i drejtorit, kualifikimi, përvoja dhe emri i shkollës.

Sami Istrefi- sa i përket vërejtjes që u paraqit lidhur me pikën e 2-të të rendit të ditës duke kërkuar raport për 3 mujorin e parë, tha se akoma nuk është 3 mujori i parë, dhe tek në muajin e 4-të mund të jepet Informatë e hollësishme për 3 mujorin e kaluar. Kurse lidhur me pikën 3 të rendit të ditës, tha se e ka kaluar edhe diskutimin publik dhe sipas rregullativës ligjore kjo duhet të vjen prap për shqyrtim në Kuvend. Ndërsa lidhur me pikën e 4-të të rendit të ditës që u propozua të heqet, tha se kjo drejtori ka paraparë që në këtë muaj ta kemi për shqyrtim draftregulloren për procedurat e ndërtimit dhe të legalizimit. Pika 5 e rendit të ditës, u propozua që të heqet prej rendit të ditës dhe pajtohem. Në vazhdim lidhur me pronat, duke iu

referuar vendimit të Kryetarit të Komunës, më 16.3.2010, tha se është marrë vendim duke u autorizuar Drejtoria e Kadastrit që për këtë qytetar i cili e ka pronën në tregun e gjelbër dhe që i pamundësohet hyrja që 10 vite, dhe kjo legjislaturë, ky Kryetar Komune ka kërkuar që t'i gjendet një hapësirë apo një rrugë e mundshme, që qytetari në fjalë ta shfrytëzoi objektin e tij. Mandej për pikën 7-të të rendit të ditës, tha që kjo pikë i plotëson kriteret ligjore, sepse edhe në thirrjet juridike që janë në atë Propozimvendim, thirret në Udhëzimet Administrative dhe në memorandum mirëkuptimin që është nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Pastaj për pikën 8 të rendit të ditës tha se aty është një gabim teknik, sepse në KPF kemi thënë që në vend të urdhëresës të jetë propozimvendim dhe i njëjti është korrigjuar. Ndërsa lidhur me vërshimet tha se kemi bërë përpjekje me të gjitha shërbimet e nevojshme së bashku me Kryetarin t'iu dalim në ndihmë qytetarëve, duke shtuar se ato vërshime janë si pasojë e ndërtimeve të egra që kanë ndodhur nga paslufta e deri më sot.

Nysret Gërxhaliu- propozoi që me propozimet që i paraqiti Kryesuesi i Kuvendit të aprovohet rendi i ditës.

Zeqir Hasani- lidhur me shkresën mbi kompensimet për delegatët e Kuvendit të Vushtrrisë, sugjeroi që të mos ndodh që për shkak të shkuarjes në pushim të një zyrtari, të mbesin pa paga, ose mospagesë të mëditjeve, sepse kjo paraqet papërgjegjësi. Pastaj kërkoj nga Kryetari i Komunës që të krijohet një hapësirë pune për shefat e grupeve asambleiste brenda Kuvendit të Komunës. Në fund duke iu përgjigjur S.Istrefit lidhur me pasqyrat financiare për 3 mujorin e parë, tha se raporti mbi pasqyrat financiare në bazë të ligjit mbi financat publike duhet të përgatitet më së largu deri më 15.04.2010 për 3 mujorin e parë të vitit 2010.

Bahrije Pllana- kërkoj Informatë me shkrim për qëllimin e vizitës në Turqi, shpenzimet që janë bërë për këtë vizitë dhe përbërjen e delegacionit, duke paraqitur vërejtje, pasi që është anashkaluar subjekti i dytë politik në Komunë, AAK. Pastaj tha që po ndërtohet një stazë (shëtitore) mbi bankinë të lumit "Sitnica", por brenda hapësirës së bankinës shihet se po ndërtohen themele për ndonjë objekt, prandaj kërkoj Informatë me shkrim se çfarë është duke u ndërtuar në atë hapësirë afër shëtitores. Në fund tha se në planin e Kryetarit është premtuar se do të punohet lidhur me hapjen e shkollës së muzikës, prandaj paraqiti interesim se çka është punuar deri më tani për hapjen e kësaj shkolle.

Besim Jashari- pasi që u pajtua me tërë atë që e tha shefi i grupit asambleistë nga LDK-ja, paraqiti vërejtje lidhur me atë që Kryesuesi i Kuvendit qysh në fillim të seancës kërkoj që të heqet pika e 5-të e rendit të ditës, dhe në vend të saj ta kemi shqyrtimin e draftregullores e cila na u është dhënë tani para fillimit të seancës, dhe shtoi se Kryesuesi i Kuvendit, që njëherit është edhe Kryesuesi i KPF-së është dashtë ta mendoj mirë këtë çështje gjatë shqyrtimit të kësaj pike në KPF, se fakti që tani kërkon me u hjek kjo pikë e rendit të ditës nga Kuvendi, tregon se nuk ka qenë diçka në rregull aty, sepse të kërkosh ta heqësh një pikë të rendit të ditës duhet me dhënë argumente të qëndrueshme dhe të pranueshme para Kuvendit, pasi që nuk është serioze të propozohet heqja e një pike të rendit të ditës dhe në vend të saj të propozohet një pikë tjetër, pa dhënë arsyetim dhe argumente. Në vazhdim lidhur me draftregulloren që e kanë marrë para seancës bashkë me Informatën që e morëm, që e ka kërkuar këshilltarja e Kuvendit, tha se bëhet fjalë për një joseriozitet, sepse edhe në mandatin e kaluar kemi pasë shumë raste kur materialet na vijnë para seancës, dhe kjo paraqet një mosrespekt ndaj neve si këshilltarë. Pastaj paraqiti vërejtje për shkarravinat e shumta në draftregullore.

Idriz Ismajli- tha që pika 3 e rendit të ditës ka qenë muajin e kaluar, ka kaluar leximin e parë, ka shkuar për diskutim publik dhe ka qëndruar një muaj në diskutim publik, dhe pasi që nuk ka pasë asnjë vërejtje nga diskutimi publik, për hir të transparencës e kam marrë një model dhe e kam shtuar si material shtesë që të

lexohet edhe ky dhe të krahasohet me atë që është votuar në këtë Kuvend, në mënyrë që sa më shumë të keni material dhe njohuri.

Ferit Idrizi- tha që jemi marrë vesh në KPF që të jetë një pikë e veçantë e rendit të ditës për ambientin, që e propozoi edhe shefi i grupit asambleistë nga LDK-ja, dhe e përkrahu që një pikë e tillë e rendit të ditës të diskutohet dhe të futet si pikë e fundit, kurse sa i përket ujit, tha se jemi marrë vesh që në kuadër të kësaj rregullore që bëhet, të diskutohet edhe problemi i ujit. Lidhur me propozimin e S.Kadriut që të debatohet për dy rrugët e përmendura gjatë fjalimit të tij, tha që nuk jemi kompetentë, sepse ato janë rrugë regjionale, dhe Kryetari i Komunës duhet të ushtron ndikimin e vet duke iu bërë presion në mënyrë që dy rrugët në fjalë urgjentisht të trajtohen.

Bajram Mulaku- lidhur me pyetjen e S.Kadriut, u përgjigj se rruga Polac-Vushtrri nuk është akoma e kryer, duke njoftuar se ka pasë takim me mbikëqyrësin, dhe se ata i kanë parasysh të gjitha dëmet, pasi që dëmet janë bërë vetëm në bankina, e jo në trupin e rrugës, mirëpo shtresa e fundit e asfaltit nuk iu ka dhënë dhe në kuadër të saj të gjitha gabimet do të përmirësohen në atë rrugë. Ndërsa sa i përket rrugës tjetër, tha se është rrugë regjionale, dhe shtoi se është duke bërë presion pandërprerë, por është një rrugë që ndoshta konfiguracioni ndikon në atë rrugë, pasi që pjesa e rrafshhtë shumë shpejt po priset duke u krijuar gropa të vogla, të cilat e vështirësojnë qarkullimin.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 24 vota “për” , 8 “kundër” , të tjerët “abstenim” , aprovoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Kuvendit të Komunës.**
- 2. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat buxhetore dhe realizimin e buxhetit janar-mars 2010.**
- 3. Shqyrtimi i Draftregullore për trajtimin e ndërtimeve pa leje në K. e Vushtrrisë, (shqyrtimi i dytë).**
- 4. Shqyrtimi i Draftregullore për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i parë).**
- 5. Shqyrtimi i Draftregullore për përcaktimin e kritereve të përfituesve material ndërtimor për ndërtim dhe meremetim të objekteve të banimit.**
- 6. Shqyrtimi i Propozimvendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në rrugë publike.**
- 7. Shqyrtimi i Propozimvendimit për themelimin e komitetit për parandalimin dhe eliminimin e punëve më të rrezikshme për fëmijët në Komunën e Vushtrrisë.**
- 8. Shqyrtimi i Propozimvendimit për racionalizimin e përdorimit të ujit të pijes gjatë periudhës së verës.**
- 9. Shqyrtimi i Kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike për shtruarje me kubëza të disa rrugëve dhe ndërtim të ujësjellësit në qytet.**
- 10. Shqyrtimi i Kërkesës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport për ndihmë klubeve sportive të komunës.**
- 11. Shqyrtimi i Propozimit për ndarje të mirënjohjes poetes shqiptare PUNËTORIE ZIBA.**
- 12. Të ndryshme.**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Kuvendit të Komunës.

Pajazit Pllana- kërkoi që të riformulohet kjo pjesë e fjalimit të tij dhe të thuhet në këtë mënyrë: “furnizimi me pajisje mjekësore në QKMF në Vushtrri, dhe me material laboratorik, sipas raportit të Drejtorisë për Prokurim figuron të njëjtat kushte, i njëjti përfitues”.

Bajram Mulaku- në faqe 9, kërkoi që të korrigojohet pjesa e një fjalisë të tij dhe të bëhet kështu: “edhe kjo urë ka qenë në mesin e 15 urave si donacion i Qeverisë”.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet procesverbali me vërejtjet e anëtarit të Kuvendit Pajazit Pllana, dhe Kryetarit të Komunës, Bajram Mulaku.

2. Shqyrtimi Informatës për të hyrat buxhetore dhe realizimin e buxhetit janar-mars 2010.

Refik Ramaj- tha që është titulluar si Informatë e punës për muajin janar-mars 2010, kurse në zhargonin financiar gjithkund përdoret termi pasqyra financiare. Pastaj paraqiti vërejtje që materialet po vijnë të pa lekturuara, që përveç gabimeve drejtshkrimore, po ka gabime të rënda edhe në strukturë të fjalive, dhe shpeshherë po marrin konotim tjetër nga ajo që po shihet përmbajtja. Në vazhdim tha se pasqyrat financiare në një pasqyrë për fondin e njëjtë duhet të krahasohen ato që janë të vitit të kaluar, ato këtë vit. Mandej tha se Kuvendi ka nevojë për një formë tjetër të pasqyrave dhe të analizave, kurse këtu ka vetëm një përshkrim të të dhënave që i dërgohen Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, por nuk ka një analizë të çështjeve dhe nuk ka krahasim logjik që ka një konsistencë të vazhdueshme, pra nuk është ndërtuar një sistem i raportimit të mirëfilltë i pasqyrave menaxheriale. Në vazhdim tha se fatkeqësisht edhe sugjerimet tona po kalojnë në heshtje, dhe po praktikohet vazhdimisht një shabllon i caktuar, i cili nuk i kontribuon askujt. Sa i përket investimeve kapitale nga të hyrat vetanake, tha se është shumë domethënëse dhe kjo kërkon masa shtesë nga menaxhmenti i Komunës dhe nga Kryetari, sepse kategoria e cila hapë perspektivën e zhvillimit ka një ngecje të konsiderueshme, prandaj investimet kapitale duhet të kenë prioritet, kurse investimet kapitale që janë të shfrytëzuara në tërësi nga i tërë buxheti në total prej 3.04 %, kjo flet për një performancë jo të volitshme, për një mori aksionesh që duhet të ndërmerren nga Kryetari dhe drejtoritë përkatëse që janë të inkuorporuara në këto çështje, sepse nëse i bëhet një analizë pasqyrës përmbledhëse, atëherë se del se Komuna ka një performancë të kategorisë së shpenzimeve, e jo të zhvillimit, dhe kërkoi që të intensifikohen aktivitetet në mënyrë që kjo strukturë urgjentisht të përmirësohet sepse është në dëm të zhvillimit të Komunës. Sa i përket tatimit në pronë paraqiti vërejtje duke thënë se derisa në vitin 2010 të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë realizuar 20.507 € nga tatimi në pronë, që përsëri nuk kemi një zberthim të asaj se cilat nga këto sa janë të viteve paraprake, por në bazë të pasqyrës figuron vetëm viti 2009, ku janë realizuar 20.507 € , prandaj pyeti në bazë të çkafit një reduktim i tillë i planifikimit, pse kaq pesimiste Komuna kur vitin e kaluar ka qenë dyfishi i realizuar? Gjithashtu edhe te realizimi janë planifikuar 12.000 €, kurse janë realizuar 17.000 €. Fatkeqësisht me këtë avaz vazhdohet edhe tek financat publike, dhe ka shprehje joprofesionale dhe jologjore, duke shtuar se biznesi punoi apo nuk punoi, është i regjistruar, taksa në firmë është e obligueshme. Në fund tha se gjatë fushatës paraprake Kryeministri dhe Kryetari i Komunës ka premtuar 5 projekte për Pestovë, dhe Kryetari prap ka premtuar që në vitin 2010 shkolla fillore në Pestovë do të ndërtohet, kurse është heq, dhe kërkoi Informatë me shkrim pse është hequr prej këtij viti.

Nysret Gërxhaliu- tha se drejtori i financave jep një raport jashtëzakonisht konciz, konkret dhe të kuptueshëm edhe për neve që nuk jemi ekonomistë, dhe tha që kjo nuk është pasqyrë financiare, por është Informatë. Në vazhdim paraqiti vërejtje duke thënë se në mes planifikimit dhe realizimit ka ndryshim të theksuar, sidomos në raport me vitin 2009, edhe në tabelat faqe 7, 8 dhe 11.

Zeqir Hasani- paraqiti vërejtje duke thënë që nuk është performancë e mirë anulimi i shpeshtë i tenderëve, dhe kërkoi që të bëhet tenderi për mirëmbajtjen e aparateve kundër zjarrit, si kusht themelor për sigurinë e objekteve publike: spitaleve, shkollave, Komunës, pasi që në bazë të informatave ata janë pa afat qe 6 muaj dhe janë të pavlefshëm. Kurse sa i përket Informatës që ka kërkuar lidhur me tatimin në pronë dhe taksën komunale, tha se është një Informatë joprofesionale, i ka dy rreshta dhe nuk shpjegon asgjë. Ndërsa sa i përket raportit mbi të hyrat vetanake për muajin mars, raporti mbi ngarkesat dhe inkasimet e taksës komunale për biznese është mjaft joprofessional, mbi të gjitha del në pah se inkasimi ka qenë vetëm 44 % në vitin 2009, e jo afër 100 %, siç është paraqitur nëpër pasqyra financiare të vitit 2009. Në vazhdim tha se në këtë raport thuhet se të hyrat e inkasuara janë 84.495 €, kurse në raportin e paraqitur në mbledhje të Kuvendit mbi të hyrat vetanake të pasqyruara në pasqyrat financiare, shuma e mbledhur nga taksat komunale figuron 121.053 €, pra kemi një mospërputhje për 36.000 €, prandaj kërkoi shpjegim për këtë. Gjithashtu informoi se në bazë të shënimeve që vijnë nga terreni, del se buxheti komunal është duke u dëmtuar në mos mbledhjen dhe mos seriozitetin në inkasimin e taksave komunale, pasi që bizneset e mëdha as në vitin 2009 dhe as në vitin 2010 nuk iu janë përgjigjur obligimit për pagesën e taksës komunale. Mandej tha se e njëjta situatë e inkasimit dhe ngarkesave është edhe te tatimi në pronë. Kurse sa i përket vërejtjes që kemi bërë lidhur me pajisjen e bizneseve me leje pune (që ka qenë një pajisje 30 % vitin e kaluar), tha se ky avaz po vazhdon edhe tash, pasi që deri më datën 31.03.2010 janë pajisur vetëm 26 biznese me leje pune.

Besim Jashari- faqe 7, të hyrat vetanake për muajin mars, sektori i tatimit në pronë, duke iu referuar paragrafit të parë, tha se nëse vitin e kaluar paska pasë vërejtje se janë kthyer shumë fatura, drejtorja u dashtë me ndërmarrë masa që kjo të mos përsëritet në vitin 2010. Pastaj tha në vend se të na tregohej se në vitin 2009 nuk janë shpërndarë këto fatura me arsyetim të paqëndrueshëm, kemi ndërmarrë masa dhe kemi reaguar dhe në vitin 2010 nuk kemi lejuar që të ketë një situatë të tillë, por vetëm na thuhet se kjo situatë ka qenë jo e pranueshme në vitin 2009, dhe prap nuk jemi të kënaqur. Pastaj duke iu referuar paragrafit të 4-të, tha del se 51 % ka qenë inkasimi nga ajo që është faturuar, ndërsa nuk tregohet cila situatë është në vitin 2010. Nëse paska qenë 51 % realizimi nga ajo që është faturuar, a ka përmirësim në vitin 2010, dhe nëse ka cili është përmirësimi? Pastaj në faqe 11 tek "Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik", është 125 € planifikimi mujor, në vitin 2009 ka pasë realizim 570 €, ndërsa në realizimin për vitin 2010 është 80 €, nga kjo shihet se inspektimi nuk është as për së afërmi në nivelin që do të duhej të ishte. Në vazhdim tha se ka me dhjetëra kafiteri në Vushtrri që është mëkat me hy në to, dhe me i lejuar me afaruar ato, pasi që kanë qarqaf të zhytur, të djegur me cigare, dyshemeja e zhytur, sepse pushteti nuk iu kushton rëndësi mbrojtjes së konsumatorëve, pastaj ka edhe ordianca në të cilat dominon papastërtia, prandaj nëse do të bëhej një inspektim i mirëfilltë, shumë më i madh kishte me qenë edhe inkasimi nga inspektimet, edhe situata do të ishte shumë më e mirë në aspektin e kushteve të afarimit dhe të akomodimit të njerëzve. Kurse te "Qiraja e Tregut" thuhet planifikimi ka qenë 2.500 €, ndërsa realizimi në mars është 95 €, dhe tha se po shihet çfarë dallimi.

Xhylsime Feka- te realizimi mujor në shëndetësi 4.697 €, ndërsa te tregu 95 €, paraqiti vërejtje tek ekzekutivi pse e lejon një gjë të tillë, pasi që dihet se tregu zhvillon biznes, kurse shëndetësia thithë participimin e qytetarëve, që dihet në çfarë gjendje janë. Pastaj nuk e ka të qartë kur flitet për "Shfrytëzimin e pronës komunale

(kiosqet)", tha se Komuna e din se sa kiosqe ka dhe sa ka pronë komunale në këtë aspekt, dhe ka planifikuar 883 €, kurse ka realizuar 4.785 €, duke pyetur se qysh ka ardhur kjo shifër? dhe tha se e njëjta situatë është edhe te disa sektorë tjerë, është edhe te "Përgatitja e planit urbanistik dhe inspektimit që kanë të bëjnë me dimensionet e pronës" është 4.343 €, ndërsa e realizuar 6.215 €. Në fund tha se këtu nuk ka asnjë të ardhur nga arsimit parashkollor, ndërsa dihet shumë mirë që ka shumë paralele parashkollore që funksionojnë dhe kanë një çmim bukur të mirë, prandaj pyeti drejtorin e arsimit pse prej aty nuk ka fare të hyra?

Sabit Kadriu- tha se Informata është e përpunuar mirë, edhe pse gjuhësisht len për të dëshiruar, dhe duhet që në të ardhmen lektorët të punojnë më tepër, sepse nganjëherë krijohet konfuzion logjik në renditjen e fjalëve në fjali, sepse pastaj i humb kuptimi logjik fjalisë. Pastaj duke iu referuar faqes 7-të, paragrafit 2, tha se dëshiroi ta di se nëse brenda 3 mujorit të parë keni arritur të regjistroni 60 objekte afariste, a jeni të bindur se i keni të regjistruar të gjitha objektet afariste dhe bizneset që veprojnë dhe nuk paguajnë tatimin komunal. Në vazhdim kërkoi nga drejtori i drejtoratit që në të ardhmen ta kemi një pasqyrë reale lidhur me të gjitha ato objekte dhe biznese afariste të cilat veprojnë në Komunë dhe nuk paguajnë taksën komunale, sepse nëse i hyjmë kësaj çështje në detaje, do të shohim se e kemi një realitet më ndryshe.

Sami Istrefi- duke iu referuar faqes 11, tha se edhe në KPF e ka shtruar kërkesën që në Komunën e Vushtrrisë funksionojnë tre gurthyes dhe Komuna nuk e vjelë asnjë taksë komunale nga ata gurthyes, prandaj propozoi që të inspektohen këta gurthyes dhe të pajisen me leje komunale ose me ndonjë dokument tjetër ligjor. Poashtu propozoi që në të ardhmen të shikohet se a kemi të drejtë ligjore t'i pajisim me leje komunale antenat e ndyshme nga VALA, IKPO, dhe operatorë tjerë, dhe kërkoi nga Drejtoria e Urbanizmit që së bashku me inspeksionin të inspektohen këto lokacione me qëllim që shfrytëzuesit e atyre antenave të pajisen me leje dhe ta vjelim taksën komunale, sepse shumica e atyre antenave janë të vendosura nëpër prona private me qëllim që të marrin një qira.

Esat Beka- lidhur me disa të hyra, për tokën e paluajtshme të Komunës, tha se ka disa dokumente që tregojnë se njerëz të caktuar mbledhin të holla nga prona e Komunës, dhe përmendi si shembull tokën e Komunës e cila gjendet në Stanoc, me ç'rast kooperativa bujqësore "Elan" e shfrytëzon atë tokë, kurse ajo tokë është pronë e Komunës, merr qira nga ajo, pasi që ka bërë kontrata me qytetarë, dhe pyeti Drejtorinë e Financave se sa ka Komuna të hyra në këtë rast?

Nasuf Aliu- duke iu referuar informatave që ka marrë nga Zyra për ekonomi, njoftoi se deri më tani janë mbi 480 biznese të regjistruara nga muaji janar deri në muajin prill. Pastaj tha se të hyra nga tregu kemi pasë pak, por deri dje kemi mbi 17.000 € të hyra vetëm në muajin prill, duke thënë se jemi duke e bërë një plan të punës, dhe nga java e ardhshme do ta merr një aksion edhe Drejtoria e Inspeksionit, duke shpresuar që borxhin që e kanë tregtarët në treg, Komuna do ta arkëton.

Isuf Jashari- tha se raportet që i marrin nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe nga sistemi i menaxhimit të financave, është një raport veç me shifra, që nëse qitet në Kuvend ai raport, shumica prej delegatëve nuk dijnë as me shikuar, mirëpo jam munduar që t'i thjeshtësoi sendet dhe në vija të trasha kam përpiluar Informatën për të gjitha llojet e shpenzimeve në të gjitha fondet ekonomike, si dhe të hyrat vetanake. Kurse sa i përket pyetjeve të shpeshta nga delegatët lidhur me atë pse palinifikimi i vogël, realizimi i madh, pse në Informatë nuk po pasqyrohen të hyrat e viteve të kaluara? duke u përgjigjur se çdo pagesë financiare që bëhet në tatim në pronë ose taksë në firmë në bankë, kur e marrin raportin bankar nuk e specifikon cila e hyrë e cilit vit ka qenë, por vetëm e përcakton psh shumën e përgjithshme të të hyrave në tatim në pronë. Kurse sa i përket planifikimit, tha se 868.719 € janë të hyra të planifikuara, dhe duke iu referuar faqes nr. 11, tha se deri në fund të vitit janë 868.719 € të hyra të planifikuara, dhe nëse pjesëtohet me 12, shikoni se sa po dalin të

hyrat mujore, por nëse të hyrat mujore shpërndahen në të gjitha kategoritë e inkasimit, dhe kur të krahasohet me realizim, planifikimi del shumë i vogël, kurse realizimi shumë i madh, dhe kjo për arsye se me rastin e marrjes së qarkoreve buxhetore, kurse dihet që është rritur niveli i grantit qeveritar, dhe janë zvogëluar të hyrat me qëllim që në momentin kur të realizohen të hyrat në bazë të planifikimit, me një vendim të Kuvendit rriten të hyrat aq sa mund të realizohen. Në fund tha se kjo është Informatë, dhe nuk është as raport as analizë.

Refik Ramaj- duke iu referuar Ligjit mbi menaxhimin financiar dhe përgjegjësitë, dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, tha se raporti mujor, që na po i thojmë Informatë, quhet raport mujor i të hyrave, kurse për 3 mujor quhet pasqyrë e të hyrave. Nërsa lidhur me atë që tha drejtori se nuk mund t'i deshifrojnë të hyrat në bankë, tha se është e vërtetë që në bankë nuk shkruan për cilin vit është borxhi, mirëpo është shërbimi profesional që duhet me identifikuar se për cilin vit janë të hyrat dhe të kategorizohen sipas viteve. Në vazhdim tha se korniza afat mesme e shpenzimeve e ka një limit, dhe nëse shkohet me planifikim real (siç tha edhe drejtori) Komuna ka më pak benefite, dhe pyeti pse Kuvendit nuk i sillen dy raporte: planifikimi real që do të quhet menaxherial, kurse tjetri raportim në institucionet shtetërore që jemi të kushtëzuar për këto arsye dhe për shkak të benefitit të Komunës. Kurse për raportet tjera, tha se do t'i propozon drejtorisë që të dalin shumë më të qarta përmes grafikonit dhe delegatët që nuk marrin vesh në financa në grafikon do të shohin trendin e rritjes dhe të zvogëlimit.

Bajram Mulaku- kërkoi që të kemi një standard të dokumenteve dhe kërkoi që të lekturohen materialet të cilat vijnë në Kuvend. Kurse sa i përket planifikimit, tha se është bërë një gabim, qeveria e planifikon, dhe ka planifikuar mbi 800.000 €, kurse është dashtë m'i planifikuar rreth 1.200.000 €, dhe në bazë të atij planifikimi ka qenë e obliguar drejtoria me shpërndarë atë planifikim, por kjo nuk dmth që në të ardhmen na pengon, pasi që neve na pengon kur nuk kemi realizim. Në vazhdim tha që drejtoria duhet me u angazhuar për të parë se sa kemi borxh dhe sa është realizuar ai borxh, pra bizneset tona sa i kanë borxh Komunës, duke shtuar se kjo është pasqyra më e rëndësishme që i mungon kësaj Informate. Pastaj përkundër asaj që u kritikua inspeksioni, bëri të ditur se inspeksioni është duke punuar mirë.

3. Shqyrtimi i Draftregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje në K. e Vushtrrisë, (shqyrtimi i dytë).

Nysret Gërxhaliu- sa i përket nenit 11, tha se nuk është i precizuar, pasi që qytetari nuk e din se çka shkruan në Ligjin 2004/15, dhe krijon mundësi që zyrtarët të interpretojnë ligjin sipas tyre, kurse qytetarët duhet ta lexojnë edhe ligjin, pra nuk precizohet se kush duhet të vlerësoi kushtet që duhet të plotësohen dhe sa kushtojnë ato. Pastaj lidhur me nenin 17, tha se taksat janë të rritura, duke shtuar se nuk i kontribuojnë legalizimit. Në fund tha se nëse nuk plotësohen dhe nuk precizohen këto dy nene, Rregullorja në fjalë do ta ketë fatin e njëjtë sikur të rregulloreve të mëparshme që janë aprovuar në këtë Kuvend.

Ismet Gashi- tha se propozimi që është bërë në seancën e kaluar që draftregullorja të shkon nëpër të gjitha bashkësitë lokale të diskutohet, nuk ka pasë vërejtje kundër atij propozimi. Mandej tha se është dashtë që neve sot të na vjen një raport ashtu siç e parasheh Udhëzimi Administrativ 2008/9 mbi transparencën e kuvendeve komunale, një raport i shkruar prej hartuesit se ku është mbajtur diskutimi publik, a ka pasë vërejtje, çka është marrë si e arsyeshme që është inkorporuar, çka nuk është marrë, dhe sot na të debatojmë rreth atyre. Në vazhdim tha se kemi të bëjmë me dy drafte: draftin që e ka përgatitur drejtoria dhe poashtu e vlerësoi pozitivisht që drejtoria ka sjellur edhe një draft tjetër, pasi që modeli që e ka përgatitur USAID-i është shumë më i mirë, mirëpo ai nuk ka qenë fare në diskutim publik, nëse ka qenë ky pari. Pastaj sugjeroi që rregullorja në fjalë të mos vjen në Kuvend pa u debatuar

në Komitetin për Urbanizëm, i cili është organi më kompetent pas drejtorisë për t'i dhënë fjalën përfundimtare për të na ardhur neve në Kuvend. Në fund paraqiti një vërejtje për Kryesuesin e Kuvendit për shkak të shkeljes së dispozitës ligjore 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me afatin e dorëzimit të materialit, pasi që kurrë nuk e marrim materialin 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve.

Sabit Kadriu- tha se model Rregullorja e USAID-it ka udhëzime shumë të sakta dhe është një model i mirë që na duhet ta shfrytëzojmë, sepse po ndodhin ndërtime të ndërtesave të mëdha të cilat nuk i përfillin etazhet, nuk i përfillin rregullat urbanistike, poashtu kemi raste kur dikush ia zënë edhe diellin një shtëpie tjetër dhe njerëzit e asaj shtëpie privohen nga e drejta e privatësisë familjare për të qëndruar në shtëpitë e veta, ose duhet të qëndrojnë vazhdimisht me perde. Mirëpo për të mos ndodhur ky kaos urbanistik duhet ta lexojmë përsëri këtë Rregulloren e USAID-it, kurse këtë Rregulloren tjetër nga qeveria komunale ta përpunojmë edhe njëherë, sepse nuk koincidon në të gjitha rastet me Rregulloren e USAID-it. Në fund tha se është mirë që Rregullorja nga qeveria komunale të qarkullon edhe për një kohë, e pastaj ta aprovojmë.

Idriz Ismajli- tha që më së miri kishte me qenë sikur të kishte Ligj për legalizimin. Pastaj tha që një rregullore më mirë të shqyrtohet disa herë, se sa me dal me gabime. Poashtu më mirë është të mos bëhet legalizmi, se sa të legalizohet dikund për disa mjete që i inkasohen për Kuvendin e Komunës, e të cilat mjete do të na kthehen bumerang në të ardhmen për shkak të shkeljeve tjera. Në vazhdim lidhur me Draftrregulloren që ka qenë në diskutim publik tha se ka ngjashmëri të madhe me Rregulloren e USAID-it, por ka disa ndryshime që kishte me qenë mirë të harmonizohen. Kurse njoftoi se gjatë diskutimit publik nuk ka pasur asnjë vërejtje.

Ferit Idrizi- propozoi që draftrregullorja të shtyhet edhe për një muaj, pasi që kjo draftrregullore do të ballafaqohet me zgjedhjen e çështjeve që janë të akumuluar me vite, dhe njëkohësisht kërkoi t'iu shpërndahet individëve që janë intelektualë nëpër lokalitete.

Bajram Mulaku- pajtohem që të shkon prap në diskutim publik, por propozimi për ta dërguar Draftrregulloren nëpër bashkësi lokale, është e pamundur të zbatohet ai propozim, mirëpo Draftrregullorja mund të vendoset në webfaqen e Komunës dhe secili ka mundësi të jap mendimin e vet për çdo nen. Poashtu tha se mund të caktohet një termin i ri për thirrje të një diskutimi tjetër publik. Në vazhdim tha se Rregullorja që ka qenë deri më tani nuk ka qenë praktike, dhe me atë Rregullore nuk është mbledhë asgjë, prandaj duhet ta bëjmë një Rregullore të zbatueshme, me të cilën mund të bëjmë legalizim përmes asaj Rregulloreje.

Muharrem Shabani- duke u thirrur në Statut dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, tha se nuk ka "bashkësi lokale", por ka fshatra dhe lagje urbane. Pastaj tha se çështja e veprimit në terren është e nevojshme që të mobilizohet shoqëria civile, grupet parlamentare dhe format e ndryshme të veprimit, por edhe përmes mediave në mënyrë që qytetarët të sensibilizohen. Në fund u pajtua që Draftrregullorja dhe Rregullorja e USAID-it të rishqyrtohen, të analizohen dhe të ipet edhe një afat një mujor dhe të kemi diçka më të mirë.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Draftrregullorja në fjalë të rishikohet edhe një herë nga propozuesi duke e marrë parasysh modelin e rregullores së njëjtë të hartuar nga USAID-i.

4. Shqyrtimi i Draftrregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i parë).

Idriz Ismajli- paraqiti sqarimet hyrëse.

Besim Jashari- tha se po përmendet shpesh diskutimi publik, dhe kërkoi të gjendet një formë që pasë diskutimit publik me pasë komente shumë të rëndësishme për t'u

bërë një Rregullore e mirë. Pastaj tha se ka rëndësi që të krijohet një besim tek qytetarët, pasi që për të marrë pjesë dikush në diskutim publik, ai dëshiron me e pa që po përfillet mendimi i tij, dhe po përfshihet ajo që është dhënë me arsye si koment në atë Draftregullore. Poashtu duhet të zbatohet në praktikë Rregullorja dhe ligjet, sepse nëse nuk ka zbatim praktik, nuk ka besim.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draftregullorja në fjalë në afat ligjor, për t'u rikthyer sërish në mbledhje të radhës së Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim.

5. Shqyrtimi i Draftregullores për përcaktimin e kritereve të përfituesve material ndërtimor për ndërtim dhe meremetim të objekteve të banimit.

Haki Maloku- informoi se gjatë diskutimit publik ka dalë një propozim për ndryshim dhe plotësim dhe kërkoi që të dihet se a do të merret parasysh ai propozim.

Sami Istrefi- tha se aty ku ka propozuar propozuesi tek neni 4, bëri të ditur se edhe në KPF kemi kërkuar që as komisioni dhe as drejtorja që të mos përcaktoj kriterin e vlerësimit në kuptimin e poenave, pasi që kemi të bëjmë me kategori të cilat janë në gjendje të mjerueshme në qytetin e Vushtrrisë dhe shumica prej tyre i takojnë kategorisë së 5-të. Pastaj propozoi që te neni 4 të inkorporohet pika 4.3.2, ndërsa te neni 4, pika 4.4.2 (shkalla e invaliditetit) të mos inkorporohet në Rregullore. Poashtu propozoi që të mos ketë poentime në këtë Rregullore. Në vazhdim lidhur me nenin 1 të rregullores në fjalë, që propozuesi propozon të ndryshohet pasusi 1.4.1 që “formimin e komisionit ta zgjedh Asambleja Komunale, e jo Kryetari i Komunës”, tha se nuk është e drejtë, pasi që edhe në suaza ligjora Kryetari ka kompetencë për të formuar komision, dhe propozoi që kjo pjesë të mos përfshihet në nenin 1.

Ferit Idrizi- pajtohet që të inkorporohet vetëm 4.3.2 prej tërë kësaj çka ka propozuar propozuesi.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 21 “për”, 5 “kundër”, të tjerët “abstenim” , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon: Aprovohet Draftregullorja në fjalë, konform të cekurave më sipër për plotësim të tekstit të propozuar.

6. Shqyrtimi i Propozimvendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në rrugë publike.

Nezir Klinaku- paraqiti sqarimet hyrëse.

Refik Ramaj- sqaroi se nuk ka thënë që është punuar në mënyrë joprofesionale, por ka thënë që neve delegatëve si joprofionistë nuk kemi pasë mundësi me kuptuar, prandaj ka kërkuar me qenë një projektor në mënyrë që të na sqarohet profesionalisht me skica.

Ismet Gashi- tha se nëse ky Kuvend merr vendim për ndërrimin e tokës bujqësore, shndërrim në rrugë publike, ka qenë mirë te skica që të dihet cila është toka shërbyese që do t'i shërbente ku është prona, ku është ndërtuar shtëpia që i shërben kjo rrugë, sepse në skicë vetëm thuhet rruga e kërkuar, por nuk dihet pronari ku e ka të ndërtuar shtëpinë dhe për ku na po i lejojmë, pasi që nuk ka shtëpi pa rrugë, por është mirë ta dijmë ku, pasi që në skicë nuk e kemi.

Nezir Klinaku- sqaroi se në parcelën nr. 164 ka ndarje, mirëpo Drejtorja e Kadastrit nuk e posedon ndarjen, pra pjesën fizike që janë ndarë dhe parcela nr. 164 është e ndarë në tri pjesë, dhe një pjesë në parcelën në fjalë është shtëpia e personit që e ka bërë kërkesën, duke shtuar se aty ka edhe shtëpi të tjera dhe kjo rrugë shërben për ato shtëpi për të kaluar në rrugë prej parcelës nr. 165 që është tokë bujqësore.

Sami Istrefi- në emër të grupit asambleistë të PDK-së e mbështet, pasi që ky qytetar ka të drejtë ta ketë një rrugë. Pastaj tha që është kompetencë ekskluzive e Komunës

që në klasën e 5-të është përgjegjësi e Kuvendit të Komunës ta bëjë destinimin e tokës, kurse qytetari që kërkon rrugë, shumë mirë thuhet në Propozimvendim në gjatësi prej 100 metra dhe gjerësi 4 metra, pra në sipërfaqe të përgjithshme 400 metra katror. Në vazhdim pasi që e mbështeti propozimvendimin në fjalë, pyeti se shfrytëzuesi i pronës private a është në rrugë publike, apo është në pronë private? **Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, 6 “kundër”, të tjerët “abstenim” , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon: *Aprovohet Propozimvendimi në fjalë, ndërsa Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër obligohet që ta bën zbatimin e të njëjtit në elaboratin kadastral.***

7. Shqyrtimi i Propozimvendimit për themelimin e komitetit për parandalimin dhe eliminimin e punëve më të rrezikshme për fëmijët në Komunën e Vushtrrisë.

Muharrem Shabani- tha se nëse formohet një organ i këtillë, atëherë kemi të drejtë nga ai të kërkojmë raportim, por sipas nenit 4, ky komitet ka të drejtë t’i raporton çdo 6 muaj vetëm Institutit për Politikë Sociale në kuadër të Ministrisë dhe Mirëqenies Sociale. Në vazhdim propozoi që të shtohet një pasus në nenin 4, që duhet t’i raportoi edhe këtij Kuvendi për punën dhe aktivitetin që e bën ky komitet. **Pajazit Pllana-** kërkoi që materiali i Propozimvendimit të lekturohet, dhe tha se fjalitë nuk janë të lidhura.

Sabit Kadriu- tha se është një iniciativë që meriton të përkrahet nga të gjithë këshilltarët e Kuvendit Komunal, mirëpo para se të votojmë, është dashtë nga drejtori i drejtoratit që në disa pika të veçanta të na informoi se cilat punë janë të rrezikshme për fëmijët.

Safet Idrizi- tha se komiteti në fjalë është si rezultat i një memorandumi të nënshkruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës. Pastaj ky vendim ka për qëllim formimin e Komitetit Lokal të veprimit, i cili thirret në Udhëzimin Administrativ 17/2008, dhe këtu precizohen të gjitha punët të cilat janë të rrezikshme për fëmijët dhe cilat janë të ndalueshme. Mandej njoftoi se komiteti duhet t’i ketë 20 anëtarë, por bën edhe më pak, kurse udhëheqës i Komitetit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen e punës së fëmijëve është drejtori i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, pastaj përmendi anëtarët e institucioneve prej të cilave përbëhet Komitetit për Mbrojtjen e punëve të fëmijëve. Poashtu informoi se të gjithë këta anëtarë të komitetit në fjalë janë të obliguar t’i nënshtrohen trajnimit që të certifikohen nga Instituti për Punë Sociale. Në fund bëri të ditur se komiteti në fjalë është i obligueshëm që pasi të aprovohet nga Kuvendi, në vitin e parë me u mbledhë një herë në muaj pasi që të certifikohen anëtarët e këtij komiteti, dhe ka për obligim për t’i raportuar Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjegjësisht Institutit për Punë Sociale çdo 6 muaj.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për”, 7 “kundër”, të tjerët “abstenim” , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon: *Aprovohet Propozimvendimi në fjalë duke inkorporuar kërkesën e këshilltarit Muharrem Shabani për plotësim të nenit 4.*

8. Shqyrtimi i Propozimvendimit për racionalizimin e përdorimit të ujit të pijes gjatë periudhës së verës.

Sami Istrefi- tha se grupi asambleistë i PDK-së mbështet propozimvendimin në fjalë, por propozoi që të hiqet neni 4.1, me arsyen se me këtë Propozimvendim po kërkojmë që të bëhet racionalizimi i ujit të pijshëm, dhe njëkohësisht do të kenë mundësi disa autolarje të pajisen me leje të posaçme në një shumë të caktuar të mejteve, dhe që ai ta keqpërdorë ujin në forma të ndryshme. Prandaj tha që duke mos qenë askush i privilegjuar, kërkoi të bëhet racionalizimi i ujit për të gjithë, kurse

ata që kanë puse dhe kanë autolarje, atyre nuk mund t'iu ndalohe, por ata që kanë autolarje dhe janë të lidhur në gypat e ujësjellësit regjional, propozoi që ky ujë të mos keqpërdoret, apo të mos kenë mundësi për t'u pajisur me leje të posaçme. Lidhur me nenin 5.4, tha se nuk është kompetencë e Komunës që ta rregulloi këtë çështje, sepse është kompetencë e ujësjellësit regjional, dhe propozoi t'i shtohet: "ujëmatësi të vazhdohet tërë vitin", pasi që na e dijmë që të gjithë qytetarët faturohen në mënyrë paushalle. Në vazhdim për nenet 6 dhe 7, tha se janë dy gabime teknike, në vend që të jetë "mos zbatimi i këtij vendimi", është "mos zbatimi i kësaj urdhërese"

Veli Karaça- tha se ka kërkuar për këtë seancë një Informatë lidhur me masat që do të ndërmerren gjatë periudhës emergjente për shfrytëzimin racional të ujit, por pasi që kjo Informatë nuk është përgatitur, atëherë nuk do të kemi mundësi me debatuar dhe me kontribuar për arsye se problemi i ujit është problem i madh i cili na ka përcjellur me vite, por qëllimi i kërimit të Informatës ka qenë që na si delegatë të këtij Kuvendi të marrim një obligim që sasinë që e kemi të paraparë sipas marrëveshjes me kompaninë rajonale të ujësjellësit, me masat që do t'i planifikonim ta shfrytëzonim në mënyrë sa më racionale, pasi që përveç diskriminimit që e kemi nga kompania, që nuk furnizohemi me sasi të mjaftueshme të ujit, edhe ajo sasi që na është ndarë (që është 10 orë furnizim brenda 48 orëve) me tërë kapacitetin e fabrikës që është 600 litra në sekond, po të shfrytëzohet në mënyrë racionale, kjo sasi garanton për çdo qytetar që është i kyçur në ujësjellës rreth 80 litra ujë brenda ditës për kokë banori, por megjithatë me masat që duhet t'i ndërmarrim si pushtet lokal për ta shfrytëzuar këtë sasi në mënyrë racionale, do të përmirësonim sado pak furnizimin me ujë, mirëpo na duke pritur gjithmonë se do të ndërtohet një fabrikë dhe do të zgjedh problemin, na po i sjellim qytetarët në një situatë shumë të vështirë me mungesë për çdo ditë më të madhe të ujit. Në vazhdim tha se edhe fabrika që do të ndërtohet nuk do t'i zgjidh problemin, nëse ne nuk i edukojmë qytetarët dhe nuk marrim masa që uji i pijshëm të ruhet dhe të shfrytëzohet vetëm për pije, e jo për ujitje dhe për larje. Poashtu faturimi paushall nuk e favorizon racionalizimin e ujit, sepse ne si qytetarë të Vushtrrisë paguajmë ujin që e shpenzojnë komunat tjera: Mitrovica dhe Skenderaji, pra ne të gjithë paguajmë ujin në mënyrë paushalle dhe të barabartë, si ne që kemi prej 20 minuta deri në 2 orë, ashtu edhe ata që kanë 20-24 orë. Sa i përket eliminimit të humbjeve, apo shpërndarjes së ujit brenda Komunës nuk është rregulluar sidomos periferia e qytetit dhe fshatrat, pra nuk ka ujëmatësa nëpër fshatra se sa harxhohet uji dhe ka disa fshatra që kultivojnë perime ose punojnë tokën harxhojnë ujë më shumë se tërë qyteti dhe ai ujë harxhohet akoma pa ardh në qytet. Pastaj tha se nuk është ngritur zëri për sasinë që neve na takon, dhe në vend se ne të furnizohemi me 600 ose 550 litra në sekond, monitorimi ka dëshmuar që asnjëherë mbi 170-175 litra në sekond nuk arrin uji në Komunën tonë. Në fund, lidhur me Propozimvendimin në fjalë tha se është edhe një Rregullore për shërbime publike e cila gjithashtu i sanksionon keqpërdoruesit e ujit, dhe tha se ne kemi kërkuar që në këtë propozimvendim të rriten gjobat për keqpërdoruesit e ujit, por atë kemi mundur me bërë edhe duke e ndryshuar Rregulloren, por megjithatë është e nevojshme diçka të ndërmerret.

Pajazit Pllana- pasi që e mbështeti propozimvendimin në fjalë, paraqiti disa vërejtje, duke thënë se shkojnë në favor të qytetarit të Komunës së Vushtrrisë, sepse bëhet një diskriminim që nuk shkon në interes të shëndetit të tij dhe në interes të eksplodimit të mundshëm të ndonjë epidemie, dhe e mbështeti mendimin që nuk duhet të ketë leje të posaçme, dhe shtoi se uji është pjesë e jetës më e vlefshme se çdo gjë. Pastaj duke iu referuar nenit 3.4, tha se këtu duhet të ketë një qasje pozitive dhe të mos lejohet kjo që të shabllonizohet, sepse nëse nuk pastrohet ndërtesa, eksplodon infeksioni, dhe kjo është arbitrazh që duhet të analizohet dhe të vlerësohet mirë përmes drejtorisë dhe t'i ipet një konotacion më i arsyeshëm që uji i pijshëm të shfrytëzohet për nevoja elementare, sepse nëse nuk ka pastërti edhe atij

do t'i kërcënohet shëndeti dhe vijmë në kundërshtim me masat që duhet t'i ketë njeriu për ruajtjen e shëndetit të tij.

Qazim Azemi- lidhur me nenin 4 dhe 5, tha se duhet të hiqen “lejet e posaçme”, kurse lidhur me nenin 5, tha se po bëhet një diskriminim dhe disproporcion në mes të shpërndarjes së ujit që neve po na bëhet me hile, sepse tjetër tretman ka Mitrovica, Skenderaji, e tjetër tretman kemi ne, pasi që kemi reduktime jashtë mase dhe kjo paraqet rrezik për shfaqjen e ndonjë epidemie. Në fund propozoi që ujin e Sitnicës ta përdorim si ujë industrial, pasi që shumë do t'i kontribuonim ruajtjes së ujit të pijshëm, po që se kemi mundësi për ndonjë projekt për ujin industrial.

Ismet Gashi- duke iu referuar nenit 3.6, tha se ky nuk duhet të ekziston fare, sepse kjo ndalesë është e përhershme. Pastaj u pajtua me atë që e propozoi S.Istrefi, por tha se nëse vendoset që të hiqet ky nen, atëherë edhe nga neni 2 duhet të hiqet definicioni për “Leje të posaçme”, nëse ajo aprovohet.

Besim Jashari- tha na po e nxjerrim këtë vendim, por problemi qëndron te zbatimi i vendimit, prandaj i propozoi Kryetarit që në inspeksion në disa vende që janë të ndjeshme të merr vendime të paanshme parimore të bën ndërrimin e inspektorëve në interes të përgjithshëm.

Bajram Mulaku- lidhur me nenin 3.4, propozoi që të hiqet vetëm fjalia “sektor kolektiv”, sepse në sektorin individual pjesa absolute e shtëpive kanë puse dhe munden prej puseve me i pastruar shkallët e veta dhe trotuaret.

Dibran Përçuku- pasi që u pajtua me propozimet e delegatëve të Kuvendit, njoftoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike e ka parë të nevojshme që të përgatisim një Propozimvendim për racionalizim të ujit të pijshëm, pasi që jemi në gjendje të mjerueshme sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, dhe shtoi se jemi bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në Statutin e Komunës, në rregulloret e shërbimeve komunale (rregulloren e shërbimeve publike dhe të inspeksionit), në kërkesën e ujësjellësit regjional në Mitrovicë që të ndërmarrim diçka për racionalizimin e ujit të pijshëm. Pastaj njoftoi se e ka ngritur zërin e arsyes në vazhdimësi për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm. Në vazhdim përmendi arsyet pse jemi në këtë gjendje: keqpërdorimi i pamasë nga të gjithë, duke filluar prej Shipolit në gypin magjistrat që janë të kyçur qytetarë prej para luftës; udhëheqësia e atëhershme e ujësjellësit regjional ka qenë për neve joprofesioniste dhe nuk kanë qenë të interesuar me na ndihmuar; pas ngritjes së zërit tonë të arsyeshëm nga Kryetari i Komunës dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe zgjedhjes së bordit të drejtorëve dhe udhëheqësisë së re, gjendja ka ndryshuar për të mirë. Gjithashtu informoi se prej 1 gusht 2009 gjendja ka ndryshuar prej 20-30 %, dhe në qytet në anën e poshtme të rrugës “Dëshmorët e Kombit” furnizimi me ujë të pijshëm është 16 orë brenda 24 orëve, kurse në anën e sipërme është 10 orë. Sa i përket vërejtjeve që u dhanë nga delegatët e Kuvendit, duke filluar nga neni 3.4, tha se dikush kurrë nuk e ndal shpenzimin e ujit, dhe nëse hiqet ky nen, kemi me pasë telashe të mëdha. Pastaj tha se përgjegjësi për zbatimin e këtij vendimi është i përcaktuar në nenin 7.

Sami Istrefi- duke iu referuar nenit 7, tha se nuk e din se sa kemi të drejtë ligjore që kompania në fjalë ta zbaton këtë vendim, pasi që ne jemi aksionarë, por nuk e kemi fuqinë aq sa duhet, dhe kërkoi që të bëhet presion që ujëmatësi të vlen gjatë tërë vitit.

Zeqir Hasani- tha se Komuna e Vushtrrisë sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm 12 muaj të vitit është në situatë emergjente, dhe nuk e din nëse ka ndonjë lagje që ka ujë të pijshëm 16 orë në ditë. Pastaj lidhur me nenin 4, propozoi që të mos ketë fare përjashtime, sepse neni 4.1, 4.2, 4.3 janë të lidhur, se nëse hiqen “lejet e posaçme” duhet të hiqet komplet neni.

Besim Jashari- tha që inspeksioni përveç ndryshimeve që ka nevojë të bëhen aty, poashtu ka nevojë shumë për përkrahje, sepse nëse nuk përkrahet, inspeksioni nuk mund të kryen punë, pasi që është punë shumë e ndjeshme.

Ferit Idrizi- tha hiqet komplet neni 4, pastaj korrigohet paragrafi 3.4, hiqet paragrafi 3.6, korrigohet në çdo vend termi “urdhëresë” dhe në vend të saj shkruhet “vendim”, te neni 2 hiqet definicioni për “Leje të posaçme”.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet Propozimvendimi në fjalë me vërejtjet nga diskutimet dhe të përmbledhura nga Kryesuesi i Kuvendit.

9. Shqyrtimi i Kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike për shtruarje me kubëza të disa rrugëve dhe ndërtim të ujësjiellësit në qytet.

Ferit Idrizi- propozoi që të jetë “propozimvendim”, e jo “kërkesë”. Pastaj sugjeroi që rrugicat nëpër qytet, paramasa të mos bëhet në 4 metra, pasi që rrugët dikund janë 4 – 5 metra, mandej aty po mbetet pjesa më e keqe, por të shtrohen, sepse janë rrugica dhe duhet të shtrohen cep për cep. Në fund pyeti se sa mjete kanë mbetë në fondin për bashkëfinancim?

Zeqir Hasani- kërkoi sqarim për emrat e rrugëve. Pastaj tha se ekziston një Rregullore mbi participim të qytetarëve që deri sot kanë qenë të obliguar qytetarët që të participojnë rreth 40 % për shtruarje të rrugëve, kurse këtu shihet një shifër prej 16.42 %, dhe pyeti se a është e caktuar decidivisht sa duhet me participuar me përqindje qytetari, apo sa ka mundësi me mbledh?

Nysret Gërxhaliu- tha se ka lagje nëpër disa fshatra që kurrë nuk janë shtruar, kurse disave po iu mundësohet çdo metër me pasë të shtruar në asfalt ose kubëza, dhe përmendi si shembull rastin kur në periudhën që ka qenë me shi në Kosovë, nxënësit nuk kanë mundur me shkuar në shkollë prej Tërllabuqit në Pasomë, e që gjatësia e rrugës është vetëm 1 kilometër. Pastaj situatë të njëjtë ka edhe nëpër fshatra tjera.

Dibran Përçuku- do të isha shumë i lumtur sikur ta kishim një Rregullore për participim të qytetarëve. Pastaj si drejtori jemi në një pozitë shumë të keqe, pasi që nuk kemi kriter të caktuar për shtruarjen e rrugëve në kubëza. Në vazhdim njoftoi se shtruarjen e rrugëve e bëjnë në bazë të kërkesës së qytetarëve, nevojës së tyre, në bazë të frekuentimit të rrugëve që lidhin institucione: shkolla, ambulanta, në bazë të participimit të tyre më të madh, të gjitha këto harmonizohen dhe sjellim një konkludim. Mandej bëri të ditur se këto 11 rrugë janë paraparë në fondin që është aprovuar në Kuvend për këtë 6 mujorin e parë. Në vazhdim tha se janë rrugë me emërtime të reja, dhe është pak vështirë për ta ditur edhe ju se për cilat rrugë bëhet fjalë. Poashtu tha se kemi menduar në vitin 2007 të caktojmë kriter 50 % participim, por nuk ka pasë gatishmëri nga qytetarët për ta pranuar këtë kriter, dhe ka qenë rrezik me mbet ato mjete në suficit, prandaj kemi lëshuar pe, por iu kemi dhënë prioritet atyre që kanë dhënë më së shumti, dhe të njëjtën mënyrë e zbatojmë edhe tani. Kurse lidhur me pyetjen se sa mjete kanë mbetur nga fondi për bashkëfinancim, u përgjigj se kanë mbetur 13.248,04 €. Në fund, tha se do të përpjeket që në mbledhjen e radhës me përpiluar dhe me ua shpërndarë një hartë me emërtime të reja të rrugëve.

Muharrem Shabani- tha se me ndryshimin e shumë rrugëve që janë bërë nuk po e dijmë kah qëndrojnë dhe ku shtrihen këto rrugë, sepse duhet të kemi një kriter obligativ për neve si Kuvend dhe për drejtoritë që të ketë parasysh ato komunitete të cilat kanë paguar tatimin në pronë në mënyrë të rregullt, dhe atyre t’ua kthejmë atë tatim me projekte të cilat ua përmirësojnë kushtet e jetës së tyre, prandaj ne duhet të kemi raporte të të hyrave, që ta dijmë se prej cilave mese, sa është paguar tatimi, cilën pjesë, cilin fshat, cilën lagje i kemi ato, në mënyrë që ta dijmë se kënd ta stimulojmë, e jo në formën që në disa raste edhe sipas simpatisë partiake. Mandej nuk është kërkesa e qytetarëve një element i tillë, sepse kemi shumë rrugë në qytet dhe fshatra që akoma nuk janë kryer, kurse në disa fshatra edhe lagjet po shtrohen, e në disa fshatra tjerë nuk janë shtruar as rrugët kryesore. Gjithashtu përmendi rrugën

“Haxhi Zeka” që është e banuar në të gjitha anët me shtëpi që 30 vjet, e cila është heq, edhe pse ka qenë përpara. Në fund propozoi që rruga “Haxhi Zeka” të vazhdohet pasi që është një rrugë në interesin e qytetit.

Besim Jashari- paraqiti këto vërejtje lidhur me dokumentin në fjalë: tha se nuk dihet çka është dhe çfarë lënde është, pasi që nuk shënon fare. Pastaj tha që Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet të bën propozimvendim me kritere të caktuara dhe t’ia propozoni Kuvendit, nëse Kuvendi e sheh të arsyeshme e aprovon dhe veproni sipas atij vendimi.

Bajram Mulaku- tha që kemi qenë në baltë, si pasojë e politikave që janë përdorur para luftës, dhe ne po mundohemi me dal nga balta. Pastaj projekti që është aprovuar nga Kuvendi është projekt me participim, nuk është vetëm për qytet, por është edhe për fshatra, mirëpo deri më tani nuk ka pasur interesim nga asnjë fshat për të ndërtuar rrugë në kubëza, dhe nuk kanë qenë të interesuar me participuar për këtë. Mandej njoftoi se kanë projekte, dhe përmendi fshatin Samadrexhë, duke thënë se janë disa rrugë që do të shtrohen nëpër lagje, pra janë 4-5 rrugë që këtë vit do të shtrohen (ka edhe nëpër tjera fshatra), duke shtuar se fshatrat nuk janë të interesuar për kubëza, por për asfalte. Prandaj ky projekt prej 175.000 € po mbetet të realizohet për rrugë lokale të qytetit, poashtu njoftoi se gjithmonë ka kërkuar që rrugët të punohen me standarde. Pastaj tha se jemi duke e përdorur një formë që në ato regjione që është ndërtuar vitin e kaluar, në këtë vit më pak ose hiq nuk kemi punuar, kurse në regjionet që më pak janë prekur vitet e kaluara, këtë vit jemi duke iu dhënë përparësi. Në fund, tha se në ato raste kur qytetarët nuk po kanë mundësi me participuar, por janë rrugë kyçe që lidhen disa lagje që të dërgojnë drejt shkollave, aty gjithsesi duhet me shtruar rrugën. Gjithashtu njoftoi se rruga te popma e benzinës (në dalje nga qyteti) së shpejti do të ndërtohet, pastaj tha se ka shumë kërkesa për me bërë kanalizime nëpër fshatra.

Habib Mustafa- tha se nëse ka një regjion që ka mbet pa u përfshirë, është regjioni i 5 fshatrave të Artakollit. Pastaj tha se që 10 vite ura mbi lumin Sitnicë është e shkatërruar, edhe pse aty gjithmonë ka pasë urë, kurse tani ura nuk po ndërtohet, poashtu rrugët me të cilat ishim lidh me qendrën ose kryeqendrën nuk po ndërtohen. Në vazhdim tha se kemi presion nga qytetarët për ta ngritur këtë çështje, duke pyetur Kryetarin se kur do të merret Komuna dhe Kryetari me ndërtimin e urës mbi lumin Sitnicë? , sepse nëse pyeten banorët e Prelluzhës se kur duhet ta ndërtojmë urën, atëherë ura kurrë nuk do të ndërtohet, mirëpo ajo urë nuk i shërben vetëm asaj pjesës lartë, por ajo i shërben edhe qytetarëve të Prelluzhës, sepse qytetarët e Prelluzhës me shumicë i kanë tokat në anën perëndimore të lumit Sitnicë, prandaj është kërkesë e qytetarëve, pasi që ajo rrugë gjithmonë edhe më herët ka qenë në projekt, por kurrë nuk është realizuar dhe kërkoi që ajo të realizohet. Mandej duke iu referuar fjalimit të mëparshëm të Kryetarit i cili bëri të ditur se nuk ka pasë kërkesa nga fshatrat për shtruarje të rrugëve në kubëza, tha se një kërkesë e tillë ka qenë në mënyrë gojore përmes drejtorit të shërbimeve publike, por neve na u është thënë që rrugët me kubëza do të ndërtohen vetëm në qytet, prandaj kërkoi që të mendohet në të ardhmen edhe për atë pjesë.

Bajram Mulaku- tha se çështja e urës në Prelluzhë ka qenë preopukim edhe i gjithë kryetarëve që kanë qenë para tij, por është edhe preokupim i vazhdueshëm i tij, mirëpo nuk është projekt që e realizon Komuna, por është projekt që duhet të realizohet në Komunë, pra është projekt qeveritar. Pastaj tha se me sa ka informacione, ajo urë njëherë ka filluar të ndërtohet ndoshta edhe pas luftës, por politika ndërkombëtare nuk ka lejuar të ndërtohet ajo urë, edhe sot e tutje është e njëjta politikë që nuk po lejon të ndërtohet, kurse qeveritarët kanë kërkuar që të arrihet pëlqimi me komunitetin, pastaj do të na ndërtojnë përveç urës edhe infrastrukturën e Prelluzhës. Në vazhdim njoftoi se ka pasë edhe protesta nga banorët e Artakollit, me ç’rast përveç përkrahjes nga ana e tij për protestën, ka shprehur gatishmërinë për t’iu bashkangjitur edhe vet protestës, pasi që kanë pasë

të drejtë. Gjithashtu njoftoi se ka organizuar takim me qëllim që të arrihet një memorandum mirëkuptimi për ndërtimin e asaj ure, prej të gjitha komuniteteve, kurse komuniteti serb përveç Partisë Liberale që ka pranuar, të tjerët nuk e kanë nënshkruar atë marrëveshje, prandaj ka mbetur pa u ndërtuar akoma ajo urë, mirëpo presionet për t'u ndërtuar ura është duke i bërë në vazhdimësi. Në fund, tha se në regjionin e Artakollit nuk është punuar shumë, por janë shtruar disa rrugë, ka shkuar asfalti deri në Zhilivodë, ka nevojë edhe 700-800 metra me i shtruar që të bëhet lidhja me rrugën e Sibofcit, edhe Komuna e Obiliqit është shumë afër dhe njoftoi se ka biseduar me Kryetarin e Obiliqit dhe kanë qëndrimin që në të ardhmen ta lidhin atë rrugë (pjesë). Pastaj lidhur me shkollën tha se kemi pasë takim vonë, dhe duke u bazuar në një ligj, tha se Qeveria nuk ndërton më shkolla, mirëpo është kompetencë e komunave, prandaj do të mundohemi që edhe shkollën në Zhilivodë sivjet me nis dhe në projekt dyvjeçar ta ndërtojmë, gjithashtu do të mundohemi me nis ndërtimin e shkollave edhe në Pestovë, Bukosh dhe Karaçë. Mandej kërkoi që të mos nënçmohen disa projekte që janë realizuar dhe që janë duke u realizuar në Artakoll, duke përmendur projektin e këtij viti prej "tre lisave" e deri te "lagjeja Hasani" e më tutje, projekt i këtij viti është edhe rruga e Beçukut që lidhet me Mihaliqin.

Sabit Kadriu- pasi që përkrahu çdo projekt për shtrimin e rrugëve, kudo që shtrihen, pavarësisht nëpër fshatra apo qytet, tha se duhet të shikohen disa fshatra apo lokalitetet që nganjëherë mbesin të izoluar, duke shtuar se është krijuar një mendim i banorëve të Artakollit që atje shumë pak është punuar për rrugë dhe kanalizime. Pastaj duke e vlerësuar pozitivisht që një pjesë e fshatit Kollë po ndërtohet rruga, njoftoi se një lagje tjetër e fshatit Kollë që është shumë larg nga rruga që po ndërtohet atje ka bërë një kërkesë së bashku me Lagjen e Ferizëve nga Bruzniku që të finalizohen mbi 2 kilometra rrugë, dhe është mirë që të parashihet për t'u bërë një rrugë për të kaluar dhe për t'u lidhur me qytetin, sepse po bëhen diferencime të cilat nuk duhet të bëheshin, pasi që mbi 2 milionë euro janë investuar në fshatin Stanoc, kurse fshati Novolan me disa fshatra përreth përpara ka qenë një qendër e kulturës. Mandej tha se atje ekziston një mendim që vijnë serrat, shpërndahen nëpër lokalitete tjera, ndërsa atje jo. Gjithashtu sa i përket kanalizimeve nuk është vepruar deri më sot diçka në këtë drejtim që të shihet konkretisht për fshatrat nga Novolani deri tek Zhilivoda. Pastaj mbështeti propozimin e H.Mustafës lidhur me ndërtimin e urës në fshatin Prelluzhë. Në vazhdim paraqiti kërkesë nga këto lagje: "lagjeja Ferizi, Pecajve dhe lagjeja Islami" që në të ardhmen të mendohet për rregullimin e kanalizimeve edhe për fshatrat e Artakollit, pasi që edhe këta janë taksapagues për Komunën tonë. Është edhe një kërkesë që e ka bërë me shkrim fshati Novolan, që të lidhet edhe fshati Novolan nga magjistrallja që del për Duboc, dhe të vazhdohet deri tek shkolla ku shkojnë nxënësit, sepse nga ky fshat gravitojnë numri më i madh i nxënësve në fshatin Novolan në shkollën "Emin Duraku".

Bajram Mulaku- tha se rrugët i shtrojmë me planifikim, por ndonjë rrugë duhet me mbet e fundit, dhe ka raste kur mund të ketë ndonjë subjektivizëm, por për pjesën absolute po mundohemi me zbatuar politika të drejta, dhe shtoi se e ka parasysh që është Kryetar i të gjithëve, duke mos i nënçmuar ata që nuk e kanë votuar për të realizuar projekte. Në fund njoftoi se një kanalizim i vogël është bërë në Novolan.

Dibran Përçuku- tha që është investuar shumë edhe në Artakoll duke filluar nga Pantina, Ashlani, Druari, Mihaliqi, Zhilivoda, Strocit dhe Beçuku, duke shtuar se nuk është e vërtetë që bëjmë dallime. Pastaj tha se projektet që janë aprovuar në Kuvend, jemi të obliguar me i zbatuar, dhe të gjitha këto projekte janë të aprovuara nga Kuvendi për secilën bashkësi lokale. Kurse sa i përket projekteve me kubëza betoni, tha se kemi biseduar në takim me drejtorët e drejtorive dhe me Kryetarin e Komunës se a po i paraqesim para Kuvendit, apo veç po i informojmë, sepse 175.000 € janë ndarë për këto projekte, kurse ju u dashtë me paraqit vërejtje nëse keni dyshim për keqpërdorim ose keni argumente që këto projekte realizohen në baza

partiake ose nëse punojmë me pajë. Në vazhdim sqaroi listën e projekteve të planifikuara për shtruarje të rrugëve me kubëza në qytet. Sa i përket urës në Prelluzhë, tha se nuk varet prej neve.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Nga Buxheti i Komunës - fondi për bashkëfinancim lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 188.737.00 €, për ndërtim - shtruarje me kubëza betoni të 11 (njëmbëdhjetë) rrugëve dhe ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në dy rrugë në qytet, për të cilat komuna do të siguroj 161.751.96 €, ndërsa komuniteti 31.770.00 €.

Rrugët që do të ndërtohen:

- ***Rruga “Jeton Terstena” L=250m, b=4m, t=8cm. vlera16 087,50 €.***
- ***Rruga “Mehmet Pashë Zogaj” L=336m, b=4m, t=8cm. vlera... 22149.60 €.***
- ***Rruga “Hamdi Hajrizi”, L=266m, b=4m, t=8cm. vlera16288.10 €.***
- ***Rruga “Hamdi Krasniqi” L=260m, b=4.50m, t=8cm. vlera 18856.90 €.***
- ***Rruga “Shaban Polluzha” L=300m, b=5m, t=8cm. vlera..... 237.34 €.***
- ***Rruga “Gjon Buzuku” L=190m, b=4.5m, t=8cm, vlera13711.14 €.***
- ***Rruga “Marin Barleti” L=299m, b=3m, t=8cm, vlera14953.99 €.***
- ***Rruga “Naim Zahiti” L=110m, b=5m, t=8cm. vlera8735.80 €.***
- ***Rruga “Vëllezërit Frashëri” L=100m, b=4m, t=8cm, vlera..... 6635.00 €.***
- ***Rruga “Rushit Strovci” L=350m, b=4m, t=8cm, vlera22012.50 €.***
- ***Rruga “Sahit Avdulli” L=437m, b=3.5m, t=8cm.vlera 25572.85 €.***

Gjithsejtë:188.737.38 €.

Ndërtimi i ujësjellësit:

- ***Rruga “Sahit Avdulli” L=437 m, Ø63 mm, vlera3.376.78 €***
- ***Rrugs “Hajzer Jashari”, L=150 m, Ø63 mm, vlera 1.407.80 €***

Gjithsejtë: 4.784.58 €

Totali:.....193.521.96 €

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik që në suaza të kompetencave të tyre ligjore të i ndërmarrin veprimet e nevojshme procedurale për realizim me kohë dhe në cilësi të projekteve rrugore të cekura si në nenin paraparak.

10. Shqyrtimi i Kërkesës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport për ndihmë klubeve sportive të komunës.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Nga buxheti i Komunës- Fondi për transfere dhe subvencione, lejohen mjete financiare në shumë prej 16.300 € për ndihmë klubeve sportive të Komunës. Autorizohet Kryetari i Komunës, që në bashkëpunim me drejtorin e kulturës që të përcaktoi shumat konkrete të mjeteve të cilat do t’iu ndahen klubeve sportive të Komunës.

11. Shqyrtimi i Propozimit për ndarje të mirënjohjes poetes shqiptare PUNËTORIE ZIBA.

Ferit Idrizi- njoftoi se në KPF na ka ardhur si propozim për ta shpallur “qytetare nderi”, mirëpo KPF-ja i ka rekomanduar Drejtorisë për Kulturë se “qytetare nderi” mund të shpallen personalitetet që janë shumë të njohura dhe që kanë kontribuar shumë për qytetin tonë, prandaj në KPF kemi propozuar që t’i ndahet një mirënjohje.

Xhevahire Izmaku- tha se propozimi ka qenë për ta shpallur “qytetare nderi”, mirëpo më shumë është në mungesë të një rregulloreje për caktimin e kritereve se kush duhet të fitoi atë titull, se sa mos informacionet se kush është Punëtorie Ziba. Pastaj njoftoi se festivali “Takimet e poeteshave” këtë vit do të mbahet me 28 dhe 29 maj. Në fund propozoi që një mirënjohje të veçantë t’ia ndajmë edhe poeteshës vushtrriase e cila për dekada me radhë gjendet në gurbet, dhe quhet Sevëme Preteni-Fetiçi, e cila për shumë vite ka kontribuar me mundësitë e saj në mënyrë simbolike me mjete për çdo vit me rastin e takimeve të poeteshave.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Poeteshave shqiptare: Punëtorie Ziba dhe Sevëme Preteni-Fetiçi iu ndahen Mirënjohje për nder të mbajtjes takimit tradicional “Takimet e poeteshave shqiptare- Vushtrria 2010”.

12. Të ndryshme.

a. Çështja e ambientit.

Veli Karaça- pasi që nuk kemi material bazë, propozoi që të shtyhet për mbledhjen e radhës, duke kërkuar që të përgatitet një Informatë, pastaj të debatohet pasi që ka qenë ky muaj i higjienës, Dita e Planetit, dhe sigurisht që është dashtë dhe duhet të bëjmë diçka për ta përmirësuar ambientin.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Kjo çështje shtyhet për t’u diskutuar në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Ferit Idrizi- paraqiti dy propozime:

1. Me rishikim të buxhetit të shqyrtohet mundësia që salla e Kuvendit të bëhet me pajisje teknike;
2. Të shqyrtohet mundësia që grupet asambleiste me pasë hapësirë për punë në objektin e Komunës.

b. Pyetjet dhe kërkesat e anëtarëve të Kuvendit.

Refik Ramaj:

1. Kërkoj informatë për ndërrimin e vendit të punës të z.Fetah Rashica, pasi që në bazë të informacioneve që kemi është degraduar në mënyrë të kundërligjshme.
2. Informatë për mënyrën e dhënies në shfrytëzim të projektit të “Ura e Gurit”.
3. Ura e Pestovës po kërcënon jetërat e qytetarëve, prandaj kishte me qenë mirë që një komision profesional me shqyrtuar gjendjen e saj.
4. Informatë për emrat, mbiemrat, pozitat dhe koeficientët e të punësuarëve.
5. Kërkoj që disa seanca të Kuvendit, disa pika që janë të rëndësishme për qytetarët të transmetohen përmes ndonjë televizioni lokal, siç është TV Mitrovica.
6. Kërkoj informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për punën e njësisë së ujësjellësit në Vushtrri, se sa metra kub destinohen për Komunën e

- Vushtrrisë, sa janë humbjet teknike, sa janë humbjet administrative, sa janë kyçjet ilegale, sa janë shkyçjet, dhe me sa ujë furnizohen qytetarët?
7. Raport për ecuritë e rrjedhës së projektit të shtratit të lumit "Tërstena".

Sabri Ferati:

1. Informatë me shkrim lidhur me zgjerimin e një objekti në kompleksin e xhamisë, i cili punim po e dëmton estetikën e xhamisë.
2. Informatë me shkrim lidhur me shkollat që janë ndërtuar, pasi që tani janë dëmtuar dhe po pikojnë, pra nuk janë në gjendje të mirë, dhe si është bërë pranimi teknik?
3. Informatë lidhur me lumin "Tërstena", duke pyetur se a ka pasë punë shtesë, a është kryer puna me afat dhe pranimin teknik të saj?

Besim Jashari:

1. Informatë se si qëndron puna me zhvendosjen e autotaksive, duke pyetur pse janë zhvendos aty dhe a është zgjidhje e përkohshme?
2. Pyeti Kryetarin e Komunës se sa ka pasë të punësuar në Komunën e Vushtrrisë në vitin 2010, cila është struktura kualifikuese e tyre, gjinore dhe etnike?
3. Kërkoj nga Kryetari i Komunës që të shikoi mundësinë për sigurimin e hapësirave më të mëdha publike për qytetarët, pasi që edhe më herët ka kërkuar që të mendohet për terrene sportive, për zgjerimin e trotuarëve, sepse vazhdimisht po rritet numri i të rinjëve.
4. Në rrugën "Mehmet Konjuhi" është një urë jashtë kriterëve profesionale dhe nën të është një urë e ngushtë që nuk ka mbrojtëse, e cila paraqet rrezik për kalimtarët, dhe poashtu në dy apo tri vende mungojnë kapakët e shaktave, dhe është shumë rrezik për të rënë ndonjë fëmijë.
5. Ka raste që në rrugë të caktuara gjenden automjete që janë braktisur, të cilat rrijnë në trotuar, nuk i përdorë askush, dhe e pengojnë lëvizjen e qytetarëve, dhe kërkoj që të bëhet largimi i atyre automjeteve.
6. Rasti i pikës pritëse për autobusët te restoranti "Te Tafa" nuk shënon që është pikë pritëse e autobusit, prandaj tha që duhet të evidentohet, të bëhet shenjëzimi, por edhe në rrugët që po shtrohen me kubëza duhet të kufizohet shpjetësia e qarkullimit të automjeteve përmes shenjëzimit.

Qazim Azemi:

1. Në emër të grupit asambleistë të AAK-së kërkoj përgjigje me shkrim lidhur me atë se ku kanë shkuar punët me projektin e fabrikës së ujit.
2. Është mirë që në webfaqe të paraqiten edhe incizime dhe forma tjera që sa më transparente me qenë mbledhjet e Kuvendit për qytetarët.
3. Pyeti për disa deponi ilegale të mbeturinave, dhe kërkoj që të eliminohen, pasi që koha po nxehet dhe paraqesin rrezik për qytetarët.

Mbledhja përfundoi në orën 16:25.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi